

VENDIM
Nr. 121, datë 29.8.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “REJ ENERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”; nenit 5 pika 2 dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pikat 1 germa “a” të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2012, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Rej Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10, pikat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Rej Energy” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani